

VENDIM
Nr. 636, datë 29.7.2020

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT SHUMËVJEÇAR PËR POLITIKËN SPEKTRALE
DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 22, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e programit shumëvjeçar të politikës spektrale dhe të planit të veprimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe Autoriteti i Medias Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

PROGRAMI SHUMËVJEÇAR PËR POLITIKËN SPEKTRALE

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Ky dokument miraton programin shumëvjeçar të politikës spektrale dhe ka për qëllim realizimin e planifikimit strategjik dhe harmonizimin e përdorimit të spektrit të frekuencave, për të garantuar një përdorim efikas të spektrit të frekuencave, në përputhje me politikat e Bashkimit Evropian për përdorimin e spektrit të frekuencave, në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Përcaktimet e këtij dokumenti zbatohen për spektrin e frekuencave për përdorim civil në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive.

2. Ky dokument nuk ndikon në disponueshmërinë e spektrit të frekuencave të nevojshëm për fushën e mbrojtjes civile, ndihmës së shpejtë në rast katastrofash, si dhe në politikat e sigurisë dhe mbrojtjes.

¹ Ky vendim përfaqësohet pjesërisht me vendimin nr. 243/2012/EU, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i datës 14 mars 2012, “Mbi krijimin e programit shumëvjeçar të politikës së spektrit radio”, CELEX no. 32012D0243.

3. Ky dokument nuk ndikon në rregullimet në fuqi, lidhur me kërkesat teknike për pajisjet radio të komunikimeve dhe përcaktimet në ligjin për komunikimet elektronike, në lidhje me administrimin e spektrit të frekuencave.

4. Ky dokument nuk ndikon në rregullimet që ndjekin objektiva të interesit të përgjithshëm, në veçanti ato që kanë lidhje me rregullimin e përmbajtjes në transmetimet audiovizive.

5. Ky dokument nuk ndikon në të drejtën për ta organizuar dhe për ta përdorur spektrin radio për qëllime të rendit publik, sigurisë kombëtare, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Neni 3 **Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në nenin 3, të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Për qëllim të këtij dokumenti termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Autoritet i administrimit të spektrit të frekuencave”, është institucioni/et e ngarkuara me ligjin e komunikimeve elektronike për administrimin e spektrit të frekuencave, për qëllime civile dhe nga Plani Kombëtar i Frekuencave.

“Autoritet i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)” është autoriteti përgjegjës rregullator për komunikimet elektronike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

“Autoriteti i Medias Audiovizive (AMA)” është autoriteti përgjegjës rregullator për median audiovizive, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 97/2013, “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

“Ministri” është ministri përgjegjës për komunikimet elektronike.

Neni 4 **Parime të përgjithshme rregullatore**

1. Përdorimi i spektrit të frekuencave, në fushën e komunikimeve elektronike, kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe hapësinor, transportit, energjisë dhe transmetimeve audiovizive, duhet të bazohet në zbatimin e një sistemi autorizimi apo licencimi sa më të përshtatshëm dhe të thjeshtuar, në mënyrë që të garantohet maksimalisht fleksibiliteti dhe efienca në përdorimin e spektrit të frekuencave në këto fusha.

2. Sistemi i autorizimeve ose licencimeve për përdorimin e spektrit të frekuencave bazohet në kriteret objektive, transparente, jodiskriminues dhe proporcionale.

3. Përdorimi i spektrit të frekuencave, duhet të mbështesë:

a) zhvillimin e tregut të brendshëm duke promovuar prezantimin e shërbimeve të ardhshme digjitale në nivel kombëtar dhe të nxisë konkurrencën efektive;

b) promovimin e konkurrencës dhe inovacionit, duke siguruar shmangien e interferencave të dëmshme dhe garantuar cilësinë teknike të shërbimit, në mënyrë që të lehtësohet vënia në dispozicion e shërbimeve *broadband*, për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive rritjes së trafikut të të dhënave në rrjetet pa tel (radio);

c) përcaktimin e kushteve teknike për përdorimin e spektrit të frekuencave, duke marrë parasysh plotësisht legjislacionin përkatës, lidhur me kufizimin e ekspozimit të popullsisë ndaj fushave elektromagnetike, brenda normave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

d) promovimin, kur është e mundur, të parimit të neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve, në të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave.

4. Për komunikimet elektronike, përveç parimeve të përgjithshme rregullatore të përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, zbatohen parimet specifike në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike, si:

a) aplikimi i parimit të neutralitetit teknologjik dhe të shërbimeve në të drejtat e përdorimit të frekuencave për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, për transferimin apo dhënien me qira të të drejtave individuale për përdorimin e frekuencave;

b) promovimi i harmonizimit të përdorimit të frekuencave në vend, në përputhje me nevojën për të siguruar një përdorim efektiv dhe efikas, sipas politikave të harmonizimit në BE;

c) mbështetja e rritjes së trafikut të të dhënave dhe të shërbimeve *broadband*, duke nxitur në veçanti fleksibilitetin dhe promovimin e inovacionit, si dhe duke marrë parasysh nevojën për të shmangur interferencat e dëmshme dhe për të siguruar cilësinë teknike të shërbimit.

5. Autoritetet e administrimit të spektrit të frekuencave, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe kur është e nevojshme me ministrin, për të garantuar zbatimin koherent e në mënyrë transparente, të të gjitha parimeve të përgjithshme rregullatore si më sipër.

Neni 5

Objektivat strategjikë

Objektivat strategjikë për politikën e spektrit të frekuencave synojnë:

a) Nxitjen e administrimit dhe përdorimit eficient të spektrit radio, për të përmbushur në kohë dhe më mirë kërkesën në rritje për përdorim të frekuencave, me vlerë të rëndësishme sociale, kulturore dhe ekonomike.

b) Caktimin e një sasive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të spektrit, për të përmbushur objektivat strategjikë të agjendës digjitale, që i përgjigjet sa më mirë kërkesës për trafik të dhënash mbi rrjetet radio (pa tel), duke mundësuar në këtë mënyrë zhvillimin e shërbimeve të biznesit dhe atyre publike, dhe duke marrë parasysh njëkohësisht objektivat e rëndësishëm të interesit të përgjithshëm, të tillë si garantimi i diversitetit kulturor dhe pluralizmit të medias.

c) Kapërcimin e hendekut digjital në mbulimin me shërbime të zonave rurale dhe të largëta, si dhe arritjen e objektivave të Planit Kombëtar për zhvillimin e infrastrukturës digjitale *broadband* dhe Agjendës Digjitale, duke mbështetur aksesin në *broadband* me një shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë për të gjithë vendin, e duke mundësuar në këtë mënyrë shfrytëzimin në mënyrë maksimale të kapacitetit dhe shpejtësisë së shërbimeve *broadband*.

d) Të mundësojnë zhvillimin e shërbimeve *broadband* për komunikimet elektronike në rrjetet pa tel, duke vënë në dispozicion spektër radio të mjaftueshëm në breza eficiente, në lidhje me kostot, me qëllim që këto shërbime të jenë gjërësisht të disponueshme për publikun.

e) Garantimin e mundësive për sektorin privat dhe atë publik, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të *broadband*-it të lëvizshëm.

f) Promovimin e inovacionit dhe të investimeve, duke përforcuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, nëpërmjet aplikimit të parimeve të neutralitetit teknologjik midis zgjidhjeve teknologjike që mund të zbatohen dhe nëpërmjet një parashikimi të përshtatshëm rregullator, bazuar midis të tjerash në ligjin për komunikimet elektronike, dhe nëpërmjet lirimit të spektrit radio në harmoni me zhvillimet në BE për teknologjitë e reja të avancuara, si dhe përmes mundësisë së transferimit/tregtimit të të drejtave të përdorimit të spektrit radio, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi për zhvillimin e shërbimeve të ardhshme digjitale.

g) Lehtësimin e aksesit në spektrin radio, duke shfrytëzuar përfitimet e autorizimeve të përgjithshme për komunikimet elektronike, në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike dhe sipas praktikave të BE-së.

h) Nxitjen e përdorimit të përbashkët të infrastrukturave pasive, në rastet kur ky përdorim është proporcional dhe jodiskriminues.

i) Sigurimin dhe zhvillimin e konkurrencës efektive, në veçanti për shërbimet e komunikimeve elektronike, duke shmangur, nëpërmjet masave *ex-ante* ose të korigjimeve *ex-post*, akumulimin e tepërt të të drejtave të përdorimit të frekuencave nga kompani të caktuara, gjë që do të rezultonte në një shtrembërim të konsiderueshëm të konkurrencës.

j) Reduktim të fragmentizimit dhe shfrytëzim të plotë të potencialit të tregut të brendshëm, me qëllim favorizimin e rritjes ekonomike dhe të ekonomive të shkallës, duke përmirësuar, kur është e përshtatshme, koordinimin dhe harmonizimin e kushteve teknike për përdorimin dhe disponibilitetin e spektrit radio.

k) Shmangien e interferencave të dëmshme ose të shqetësimeve që vijnë si rezultat i pajisjeve të tjera radio, duke lehtësuar ndër të tjera zhvillimin e standardeve që kontribuojnë në përdorimin efikas të spektrit radio dhe rritjen e imunitetit të marrësve ndaj interferencave, duke marrë parasysh në veçanti ndikimin akumulativ të vëllimit dhe dendësisë në rritje të pajisjeve dhe aplikacioneve radio.

l) Promovimin e aksesit në produktet e reja dhe të teknologjive të reja, në mënyrë që konsumatorët të mbështesin kalimin në teknologjinë digjitale dhe sigurimin e përdorimit efikas të dividentit digjital.

m) Reduktim të sasisë së karbonit të emetuar nga përdorimi i pajisjeve radio, duke përforcuar eficiencën teknike dhe energjetike të rrjeteve të komunikimit dhe të pajisjeve radio.

Neni 6

Përmirësimi i eficiencës dhe i fleksibilitetit

1. Në administrimin e spektrit të frekuencave, kur është e përshtatshme, do të nxitet përdorimi i përbashkët i spektrit të frekuencave, për të mbështetur zhvillimin e teknologjive ekzistuese dhe të reja, si teknologjitë e njohjes (*cognitive technologies*), përfshirë ato që përdorin “hapësirat e bardha”.

2. Autoritetet përgjegjëse për administrimin e spektrit bashkëpunojnë për të përmirësuar fleksibilitetin në përdorimin e spektrit radio, për të promovuar inovacionin dhe investimet, nëpërmjet mundësisë së përdorimit të teknologjive të reja dhe nëpërmjet transferimit ose dhënies me qira të të drejtave të përdorimit të spektrit radio.

3. Autoritetet përgjegjëse për administrimin e spektrit dhe ministria, bashkëpunojnë për të nxitur zhvillimin dhe harmonizimin e standardeve për pajisjet e radios të komunikimit, si dhe të çdo rrjeti dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike me organet përkatëse të standardizimit. Vëmendje e veçantë do t’u kushtohet standardeve për pajisjet për personat me aftësi të kufizuara.

4. Në proceset e planifikimit dhe administrimit të spektrit do të mbështeten veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit në fushën e teknologjive të reja, si teknologjitë njohëse dhe bazat e të dhënave të vendndodhjes gjeografike.

5. Në administrimin e spektrit, sipas rastit dhe specifikave të shërbimit, caktohen kritere dhe procedura për zgjedhje për dhënien e së drejtës së përdorimit të spektrit radio, të cilat promovojnë konkurrencën, investimet dhe përdorimin efektiv të spektrit radio, si një e mirë publike, si dhe për bashkëjetesën e shërbimeve dhe pajisjeve të reja me ato ekzistuese, që promovojnë përdorimin eficient e të vazhdueshëm të spektrit radio për rrjetet, pajisjet dhe aplikacionet.

6. Kur është e nevojshme, për sigurimin e përdorimit efektiv të spektrit radio dhe për të shmangur akumulimin e spektrit radio apo mospërdorimin e tij, autoritetet përgjegjëse për administrimin e spektrit, mund të ndërmarrin masat e nevojshme, të tilla si: vendosjen e sanksioneve financiare, aplikimin e tarifave nxitëse ose heqje/revokimin e të drejtave. Masa të tilla

do të vendosen dhe zbatohen në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe proporcionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Për shërbimet e komunikimeve elektronike, të merren masa për alokimet dhe autorizimet, të përshtatshme për zhvillimin e shërbimeve *broadband*, në përputhje me ligjin për komunikimet elektronike, në mënyrë që të arrihet kapaciteti dhe shpejtësia maksimale e mundshme për *broadband*-in.

8. Për të shmangur fragmentizimin e mundshëm në dhënien në përdorim të frekuencave, si rrjedhojë e kriterëve dhe kushteve të përzgjedhjes të ndryshme, të aplikueshme për spektrin radio, të caktuar për shërbime të komunikimeve elektronike, ministria në bashkëpunim me AKEP-in dhe AMA-n, do të kryejnë një analizë të procedurave ekzistuese dhe iniciojnë ndryshimet e nevojshme ligjore dhe/ose nënligjore, duke u mbështetur në praktikën më të mira, në lidhje me kushtet dhe procedurat e autorizimit, bazuar në praktikën e BE-së dhe Kodin e ri të Komunikimeve Elektronike (EECC), të miratuar me direktivën 2018/1972/EU.

9. Me qëllim arritjen e objektivave strategjike, do të kryhet një analizë mbi sistemin aktual të pagesave për spektrin e frekuencave, në veçanti për ato që mbështeten në shërbimet satelitore *broadband*, me qëllim që këta breza të jenë më të përdorshëm, si dhe pagesat për autorizimet individuale për përdorim të frekuencave me kohëzgjatje të kufizuar, për qëllime kërkimore, testimi (provë/kërkim/matje) të teknologjive të reja, në breza të ndryshëm të frekuencave apo për frekuencat që caktohen në rastet e katastrofave, fatkeqësive natyrore, emergjencave, luftës etj.

Neni 7

Konkurrenca

1. Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave duhet të promovojnë konkurrencën efektive dhe të shmangin shtrembërime të konkurrencës, në ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në procesin e dhënies në përdorim të frekuencave, administratorët e spektrit, marrin parasysh aspekte të konkurrencës, në momentin kur u japin të drejta për përdorimin e spektrit radio, përdoruesve të rrjeteve private të komunikimeve elektronike.

2. Me qëllim garantimin e konkurrencës, pa cenuar zbatimin e rregullave të konkurrencës dhe masave të marra në zbatim të legjislacionit në fuqi, për arritjen e objektivave të interesit të përgjithshëm, në dhënien në përdorim të frekuencave nga autoritetet përkatëse, mund të aplikohen, ndër të tjera, masat e mëposhtme:

a) Kufizim i sasisë së spektrit radio, për të cilin mund të lëshojnë të drejta përdorimi për një kompani ose përcaktim kushtesh për këto të drejta përdorimi, të tilla si: sigurimin e aksesit me shumicë, sigurimin e *roaming*-ut kombëtar ose rajonal, në secilin prej brezave ose në secilin prej grupeve të brezave me karakteristika të ngjashme, si për shembull për brezat nën 1 GHz, të caktuara për shërbime të komunikimeve elektronike.

b) Aty ku është e përshtatshme, për shkak të situatës në tregun kombëtar, rezervimin e një pjese të caktuar brezi ose të një grupi brezash frekuence për t'u caktuar operatorëve të rinj, me qëllim nxitjen e konkurrencës.

c) Refuzim të dhënies së të drejtave të reja për përdorim të spektrit radio ose të autorizimeve të reja për përdorim të spektrit radio, ose caktim të kushteve të veçanta të mbulimit, shërbimit universal në dhënien e të drejtave të reja për përdorimin e spektrit radio ose për autorizimin e përdorimit të ri të spektrit radio, për të shmangur shtrembërime të konkurrencës, për shkak të caktimit, transferimit ose akumulimit të mundshëm të të drejtave të përdorimit.

d) Ndalim ose vendosje kushtesh për transferimin e të drejtave të përdorimit të spektrit radio, në rastin kur transferime të tilla mund të ndikojnë ndjeshëm në konkurrencë.

e) Ndryshimin e të drejtave ekzistuese në përputhje me parashikimet ligjore, kur kjo është e nevojshme për të korrigjuar *ex post* shtrembërime të konkurrencës, që kanë ardhur si rrjedhojë e transferimeve ose akumulimeve të të drejtave të përdorimit të frekuencave radio te një kompani.

3. Në rastin kur është e nevojshme të ndërmerren masat sipas pikës 2 të këtij neni, autoritetet e administrimit të spektrit, veprojnë në përputhje me procedurat për caktimin ose modifikimin e kushteve, në lidhje me të drejtat e përdorimit të spektrit radio, të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

4. Vendimet e marra për dhënien në përdorim të frekuencave, duhet të garantojnë që procedurat e autorizimit dhe përzgjedhjes për shërbimet e komunikimeve elektronike, promovojnë konkurrencën efektive në favor të qytetarëve, konsumatorëve dhe biznesit.

Neni 8

Përdorimi aktual i spektrit të frekuencave

1. Përcaktimi i brezave të frekuencave për shërbime të ndryshme bëhet nga Plan i Kombëtar i Frekuencave, i cili vendos kushtet bazë për caktimin dhe përdorimin e frekuencave, për përdorimin me efektivitet të spektrit të frekuencave dhe shmangien e interferencave.

2. Plan i Kombëtar i Frekuencave miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe hartohet në përputhje me radorregulloret e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU), si dhe me përcaktimet e Tabelës Evropiane të Alokimeve (ECA Table). Plan i Kombëtar i Frekuencave rishikohet në mënyrë periodike, mbi bazën e akteve finale të Konferencës Botërore të Radiokomunikacionit (WRC) dhe ndryshimeve në Tabelën Evropiane të Alokimeve.

3. Plan i Kombëtar i Frekuencave, përfshin brezat e frekuencave, për:

- a) shërbimet tokësore të lëvizshme;
- b) shërbimet tokësore fikse;
- c) shërbimet satelitore të lëvizshme;
- d) shërbimet *broadcast*/radiotelevizive;
- e) shërbimi satelitor fiks;
- f) shërbimi aeronautik;
- g) shërbimi detar.

h) Shërbime të tjera me një fushë të gjerë përdorimi në fusha të ndryshme të ekonomisë, sipas përcaktimeve të PKF-së.

4. Mënyra teknike e përdorimit të secilit brez apo nënbrez nën administrimin e AKEP-it detajohet në planin e përdorimit të frekuencave.

5. Në fushën e transmetimeve radiotelevizive, AMA, si administrator i spektrit për shërbime radiotelevizive, ka dhënë licencat për transferimet radio dhe televizive, sipas përcaktimeve në ligjin për median audiovizive dhe Planin Kombëtar të Frekuencave.

6. Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit (WRC-19) ka bërë përcaktime të rëndësishme në lidhje me spektrin e frekuencave, për shërbimet e transportit (ITS), shërbimet satelitore, shërbimet e lëvizshme, LTE etj., që do të reflektohen në planin kombëtar të frekuencave.

7. Spektri aktual i caktuar nga AKEP-i për shërbimet e lëvizshme, si dhe spektri i lirë për t'u dhënë në përdorim, jepen në tabelën e aneksit 1, bashkëlidhur.

8. Spektri aktual i caktuar nga AMA për operatorët radiotelevizivë për transmetimet numerike, përfshin pesë rrjete numerike private dhe dy rrjetet e RTSH-së, sikurse jepet në aneksin 2 bashkëlidhur.

Nevojat e spektrit për komunikimet *broadband wireless*

1. Zhvillimet teknologjike, rritja e përdorimit të pajisjeve radio dhe rritja e shpejtë e trafikut të të dhënave me brez të gjerë, kanë bërë që zgjerimi i kapaciteteve të rrjeteve të komunikimit elektronik pa tel (*broadband wireless*), është bërë një domosdoshmëri.

2. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të spektrit të frekuencave për këto zhvillime është me rëndësi për përmbushjen e kërkesës në rritje për trafikun e të dhënave me brez të gjerë dhe nxitjen e zhvillimit të shërbimeve inovative të komunikimit digjital, ku po mbështeten gjithnjë e më shumë zhvillimet e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë.

3. Bazuar në këto zhvillime teknologjike, organizmat ndërkombëtarë ITU, CEPT, kanë kaluar përdorimin e brezit 700 MHz në Rajonin 1, ku bën pjesë dhe Shqipëria, për shërbime të rrjeteve të lëvizshme LTE.

4. Bashkimi Evropian, me vendimin nr. 2017/899/EU, ka përcaktuar si datë për lirim të këtij brezi, 30 qershorin 2020, duke lënë si afat maksimal datën 30.6.2022, për rastet e justifikuara, kryesisht të lidhura me nevojën e koordinimit ndërkufitar.

5. Plan Kombëtar i Frekuencave, miratuar me vendimin nr. 277, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”, ka parashikuar te shënimet që brezi i 700 MHz (DD2), është identifikuar për shërbime të lëvizshme me brez të gjerë në të ardhmen.

6. Brezi i frekuencave 700 MHz ose i njohur si Digital Dividend 2 (DD2) është shumë i rëndësishëm për sigurimin e mbulimit universal, për zhvillimin e rrjeteve 5G dhe arritjen e objektivave, sipas Planit Kombëtar të *Broadband*, veçanërisht për zonat me sfida ekonomike, të tilla si zonat rurale, malore ose të largëta, të paracaktuara, në përputhje me fushat që janë prioritet kombëtar, duke përfshirë rrugët kryesore të transportit tokësor, për përdorim të brendshëm ashtu dhe për komunikim të gjerë si në rastin e pajisje–pajisje (M2M/IoT).

7. Në zbatim të këtij vendimi do të merren të gjitha masat e nevojshme për të garantuar vënien në dispozicion të spektrit radio, të mjaftueshëm për të siguruar mbulimin dhe kapacitetet e nevojshme, në mënyrë që të ketë në dispozicion *broadband*-in me shpejtësinë më të lartë, dhe që aplikacionet *wireless* dhe shërbimet e reja të mund të kontribuojnë efektivisht në rritjen ekonomike dhe në realizimin e objektivit për një akses në *broadband* me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë, për të gjithë qytetarët, sipas Planit Kombëtar të *Broadband*.

8. Për promovimin, përdorimin me eficiencë dhe vënien në dispozicion, në përfitim të qytetarëve dhe të konsumatorëve, lidhur me brezat e përcaktuar në Planin Kombëtar të Frekuencave, për shërbime të lëvizshme *broadband* dhe aktualisht të lira, AKEP-i do të kryejë studime novatore, lidhur me dhënien në përdorim të këtyre brezave, përfshirë kombinimet teknike midis tyre, si dhe për sa u takon çmimeve të dhënies në përdorim. Kur është e përshtatshme, AKEP-i në bashkëpunim me ministrinë, promovon aksesin në shërbimet *broadband* që përdorin brezat nën 1 GHz, në zona të largëta dhe me densitet të ulët popullsie, duke vendosur kushtet përkatëse të përdorimit.

9. Brezi i frekuencave të Digital Dividend 2, do lirohet nga përdorimet aktuale dhe kalohet për *broadband*, sipas afatit maksimal të vendosur nga BE-ja, përmes një procesi të matur, duke gjetur rrugët më të mira teknike e rregullatore, në procesin e migrimit të frekuencave dhe duke bërë kujdesin maksimal për ruajtjen e pluralizimit në media, si dhe për të garantuar që lrimi i brezit 700 MHz, nuk ndikon negativisht te përdoruesit në marrjen e shërbimeve të programeve dhe ngjarjeve të veçanta audiovizive.

10. Ministria, AMA dhe AKEP-i, në bashkëpunim, do të hartojnë një plan masash me të gjitha hapat e nevojshëm, përfshirë proceset e konsultimit me grupet e interesit, për realizimin e liritit Digital Dividend 2, sipas afatit maksimal të BE-së.

11. Administratorët e spektrit, në bashkëpunim me ministrinë, do të kryejnë një monitorim të vazhdueshëm të nevojave për kapacitete për shërbime radio dhe në bazë të rezultateve të analizës të parashikuar sipas nenit 12, do të ndërmerren rast pas rasti nismat e nevojshme ligjore e rregullatore.

12. Kur është e përshtatshme, kostot direkte të migrimit dhe/ose të rishpërndarjes së përdorimit të spektrit radio, do të kompensohen në mënyrën e duhur, sipas legjislacionit kombëtar.

13. Në mënyrë që të garantohet që të gjithë qytetarët të kenë akses në shërbimet e avancuara digjitale, përfshirë këtu edhe *broadband*-in, në veçanti në zonat periferike dhe me dendësi të ulët popullore, do të konsiderohet disponueshmëria e një pjese të spektrit radio, të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve satelitore dhe *broadband*, të cilat mundësojnë lidhjen me internet.

14. Në zhvillimet e rrjeteve të lëvizshme do të shqyrtohet mundësia e shtrirjes dhe e përdorimit të picocelave dhe *femtocells*, duke marrë parasysh potencialin e këtyre stacioneve bazë dhe përdorimin e përbashkët të spektrit të pacilësuar, për të shërbyer si bazë për rrjetet *wireless*, që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në kapërcimin e hendekut digjital.

Neni 10

Nevojat e spektrit për politikat e komunikimeve të tjera pa tel (*wireless*)

Për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve inovatore të medias audiovizive dhe shërbimeve të tjera për qytetarët, duke pasur parasysh përfitimet ekonomike dhe sociale të ekonomisë digjitale, administratorët e spektrit, në bashkëpunim, do të garantojnë vënien në dispozicion të spektrit të mjaftueshëm, për ofrimin e këtyre shërbimeve në rrugë satelitore dhe tokësore, nëse nevoja justifikohet në mënyrë të qartë.

Neni 11

Nevojat e spektrit për politika të tjera specifike

1. Në hartimin e planit kombëtar të frekuencave dhe në proceset e caktimit të spektrit të frekuencave do të sigurohet disponueshmëria e spektrit të nevojshëm, për sistemet e monitorimit e të ruajtjes së atmosferës dhe të sipërfaqes së tokës, duke lejuar zhvillimin dhe shfrytëzimin e aplikacioneve hapësinore dhe përmirësimin e sistemeve të transportit, në veçanti për sistemin botëror satelitor të lundrimit civil, të ngritur nga programi Galileo, për programin evropian të monitorimit të tokës (GMES), për sistemet inteligjente të mbrojtjes dhe të administrimit të transportit (ITS) dhe sistemet evropiane të aviacionit, sipas praktikave të harmonizuara e të miratuara në nivel evropian.

2. Në zbatim të një politike të ekonomisë së gjelbër, për të pasur një emetim të ulët të karbonit, do të kryhen studime mbi kursimin e energjisë së përdorur për pajisjet radio, duke marrë në konsideratë mundësinë për të vënë në dispozicion spektrin radio për teknologjitë *wireless*, të cilat rrisin kursimin e energjisë dhe eficiencën e rrjeteve të tjera të shpërndarjes, të tilla si: furnizimi me ujë, duke përfshirë rrjetet inteligjente të shpërndarjes së energjisë (*smart energy grids*) dhe sistemet inteligjente të matjes (*smart metering system*).

3. Në hartimin e planit kombëtar të frekuencave dhe në proceset e caktimit të frekuencave, përfshirë brezin 700 MHz, në përputhje me rekomandimet e CEPT, do të garantohet vënia në dispozicion e një sasive të mjaftueshme të spektrit radio, për të mbështetur zhvillimin e shërbimeve

të lidhura me sigurinë publike dhe qarkullimin e lirë të pajisjeve të lidhura me to (PPDR), si dhe me zhvillimin e zgjidhjeve inovatore të ndërveprueshme për sigurinë dhe mbrojtjen publike, mbrojtjes civile dhe në rastet e ndihmës emergjente ,sipas rekomandimeve përkatëse evropiane.

4. Ministria dhe administratorët e spektrit të frekuencave do të bashkëpunojnë me institucionet e kërkimit shkencor dhe akademik për të identifikuar projektet e kërkimit dhe zhvillimit dhe aplikacionet inovative, që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm socioekonomik dhe/ose një potencial për investime dhe marrin parasysh nevojat e këtyre aplikacioneve për spektër radio dhe, nëse është e nevojshme, marrin në shqyrtim caktimin e një spektri radio të mjaftueshëm për këto aplikacione me kushte teknike të harmonizuara dhe pagesa apo kosto administrative sa më të vogël të mundshme.

5. Në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave dhe në proceset e caktimit të spektrit të frekuencave, do të sigurohen brezat e nevojshme të frekuencave për realizimin e programeve dhe të ngjarjeve të veçanta, në përputhje me objektivat e përcaktuar në ligjin për median audiovizive.

6. Në hartimin e Planit Kombëtar të Frekuencave do të sigurohet vënia në dispozicion të spektrit për shërbimet e identifikimit me radiofrekuencë (RFID), të teknologjive të komunikimeve *wireless* të “Internetit të gjërave” (IoT), të teknologjive me brez të gjerë. Për këtë qëllim do të punohet për hartimin e miratimit të rregullave të harmonizuara të caktimit të spektrit radio për komunikimet *wireless*, në përputhje me praktikën evropiane.

Neni 12

Planifikimi afatgjatë dhe inventarizimi

1. Në zbatim të këtij dokumenti, me qëllim planifikimin afatgjatë të përdorimit të spektrit të frekuencave, AKEP-i dhe AMA do të krijojnë një inventar të unifikuar, të përbashkët për spektrin radio të përdorur për qëllime komerciale dhe publike.

2. Krijimi i inventarit do të shërbejë:

a) për identifikimin e brezave të frekuencave ku mund të përmirësohet efikasiteti i përdorimit aktual i spektrit radio;

b) të ndihmojë në identifikimin e brezave të frekuencave që mund të jenë të përshtatshme për t’u ricaktuar dhe mundësitë për përdorim të përbashkët të spektrit radio, me qëllim mbështetjen e politikave të përcaktuara në këtë vendim, duke mbajtur parasysh, në të njëjtën kohë, nevojat në të ardhmen për spektrin radio, duke u bazuar, ndër të tjera, në kërkesën e konsumatorëve dhe të operatorëve dhe në mundësinë për t’i përmbushur këto nevoja;

c) të ndihmojë për të analizuar llojet e ndryshme të përdorimit të spektrit radio nga ana e përdoruesve të sektorit publik dhe privat;

d) të ndihmojë për të identifikuar brezat e frekuencave që mund të caktohen ose të ricaktohen, për të garantuar një përdorim më efikas, për të promovuar inovacionin dhe për të përforcuar konkurrencën në tregun e brendshëm, për të studiuar mënyra të reja për bashkëpërdorimin e spektrit radio, në interes të përdoruesve të sektorit publik dhe të sektorit privat, duke marrë parasysh efektet e mundshme pozitive dhe negative të përdoruesit ekzistues, nga caktimi ose ricaktimi i këtyre brezave ose i brezave fqinjë.

3. Në mënyrë që të garantohet një zbatim uniform i pikës 1 të këtij neni, ministri do të miratojë një udhëzim mbi procedurat praktike, për krijimin dhe administrimin e inventarit, si dhe formatet për mbledhjen dhe furnizimin me të dhëna të inventarit, sipas praktikës të miratuar nga Bashkimi Evropian, mbi përdorimin aktual të spektrit radio dhe duke pasur parasysh respektimin e akteve ligjore në fuqi për konfidencialitetin e të dhënave.

4. AKEP-i, AMA, në bashkëpunim me ministrinë, bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian, do të përpunojnë një metodologji dhe do të kryejnë një analizë për tendencat teknologjike, të

nevojave të ardhshme dhe të kërkesës për spektër radio në sektorët përkatës dhe, në veçanti, për shërbime që mund të veprojnë në intervalin e frekuencave të përfshira nga 400 MHz në 6 GHz, me qëllim identifikimin e përdorimeve të rëndësishme, të mundshme ose në fazë zhvillimi, të spektrit radio.

5. Kopje e inventarit/apo aksesit në formatin elektronik të tij, si dhe rezultatet e analizës për çështjet e përmendura në pikat 2 dhe 4, i paraqiten ministrit.

6. Me qëllim administrimit e duhur të spektrit të frekuencave dhe krijimit të inventarit sipas këtij neni, AKEP-i ndërmerr masat e nevojshme për automatizimin e procesit të menaxhimit të spektrit të frekuencave, sipas metodave dhe teknologjive bashkëkohore.

7. Në rastet e brezave që do të identifikohen për përdorim të përbashkët të spektrit, do të përcaktohen rregulla të qarta të bashkëpërdorimit, për të garantuar përdorimin eficient dhe pa interferenca të frekuencave.

Neni 13

Bashkëpunimi ndërkombëtar

1. Spektri i frekuencave është burim natyror i fundmë. Administrimi i spektrit duhet të sigurojë përdorimin e frytshëm dhe efektiv të tij, në përputhje edhe me vendimet përkatëse të organizmave ndërkombëtarë dhe detyrimet, që rrjedhin nga konventat ose nga marrëveshjet, ku Republika e Shqipërisë është palë. Shqipëria është anëtare e ITU-së, nga viti 1922 dhe ka detyrimin për përmbushjen e angazhimeve nga aktet kushtetuese të këtij organizmi.

2. Rregullimi i spektrit të frekuencave në planin ndërkombëtar bëhet përmes Radiorregulloreve të Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU). Shqipëria bën pjesë në rajonin 1, sipas ndarjes globale së ITU-së.

3. Për rregullimin dhe administrimin e harmonizuar në planin global dhe rajonal të spektrit të frekuencave hartohet Plani Kombëtar i Frekuencave. Plani Kombëtar i Frekuencave hartohet në përputhje me radiorregulloret përkatëse të ITU-së dhe Tabelën për Përcaktimin e Përbashkët Evropian të Frekuencave (ECA).

4. Plani Kombëtar i Frekuencave përcakton brezat e frekuencave për shërbimet e radiokomunikimeve. Për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të dëmshme të frekuencave, ky plan përmban edhe dispozita që udhëzojnë përdorimin e frekuencave, si dhe përcaktime të tjera më të hollësishme.

5. Me qëllim koordinimin ndërkufitar të përdorimit të frekuencave, është e nevojshme miratimi i marrëveshjeve me vendet fqinje, për të garantuar përdorimin pa interferenca të frekuencave, në veçanti në breza të caktuar.

6. Me qëllim përmbushjen e objektivave strategjike të këtij dokumenti, është e nevojshme të realizohen, brenda vitit 2020, marrëveshjet e koordinimit ndërkufitar për brezat e Digital Dividentit 2, në kushtet e lirimit të tij nga përdorimi televiziv, për pjesën më të madhe të vendeve evropiane, me qëllim shmangien e interferencave ndërkufitare.

7. Nga AKEP-i do të kryhet përditësimi i marrëveshjeve ndërkufitare, për brezat e frekuencave që administron AKEP-i, në mënyrë që ato të përfshijnë të gjithë brezat kryesorë të shërbimeve të lëvizshme e fikse, sipas përcaktimeve në praktikën ndërkombëtare. Për këtë qëllim do të kërket asistencë dhe mbështetje nga ITU-ja.

8. Administratorët e spektrit të frekuencave, AKEP-i dhe AMA, duhet të informojnë periodikisht ministrin, për proceset e koordinimit ndërkufitar të frekuencave, si dhe çështje që u takojnë politikave të zhvillimit të rrjeteve të komunikimit dhe interferencave.

9. Në negociatat ndërkombëtare, që kanë lidhje me spektrin radio, respektohen detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për marrëveshjet ndërkombëtare dhe angazhimet e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare.

Neni 14

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve

1. Për zbatimin e këtij vendimi do të bashkëpunohet në veçanti midis ministrisë, AKEP-it dhe AMA-s. Në hartimin e planit kombëtar të frekuencave dhe rishikimin periodik të tij, ministri bashkëpunon me të gjitha institucionet e përcaktuara në ligjin për komunikimet elektronike, si ministria e mbrojtjes, ministria e brendshme dhe shërbimi informativ kombëtar.

2. Drejtoria përgjegjëse për politikën e telekomunikacionit në ministri ndjek në vijimësi zhvillimet e politikës spektrale në nivel global dhe rajonal, si dhe në BE, duke informuar rregullisht ministrin për çështje të rëndësishme të politikës spektrale, që kanë impakt në zhvillimet kombëtare.

3. Për çështje të politikës spektrale krijohet një komitet/grup këshillimor pranë ministrit. Në këtë komitet marrin pjesë përfaqësues të institucioneve administruuese të spektrit, si dhe ftohen specialistë, ekspertë të planifikimit e administrimit të spektrit. Grupi mbledhet minimalisht një herë në vit me kërkesë të ministrit ose të institucioneve të administrimit të spektrit për çështje specifike.

Neni 15

Konsultimi publik

Ministri, kur është e nevojshme, organizon konsultime publike që kanë për qëllim mbledhjen e pikëpamjeve të të gjitha palëve të interesuara dhe të opinionit publik, mbi përdorimin e spektrit radio dhe hartimin apo rishikimin e politikës spektrale.

Autoritetet e administrimit të spektrit, AKEP-i, AMA, kryejnë konsultime periodike me grupet e interesit për çështje të administrimit dhe caktimit të brezave të frekuencave të lira dhe atyre që parashikohen për përdorim/liruar, si dhe për çështjet rregullatore, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 16

Zbatimi dhe monitorimi

Mbi bazën e urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, janë krijuar grupet e menaxhimit të integruar të programeve (GMIP) dhe komitetet drejtuese strategjike, për të promovuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve, agjencive të ndryshme qeveritare, si edhe politikën dhe aktivitetet korresponduese. Komitetit Drejtues Strategjik “Ndërlidhja”, që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka në përbërje Grupin Tematik për Telekomunikacionin dhe *Broadband*, që drejtohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe me pjesëmarrje të përfaqësuesve të AKEP-it, AMA dhe institucioneve të tjera të përfshira në proces.

Nga pikëpamja operationale, Grupi Tematik për Telekomunikacion dhe *Broadband*, nën KDS “Ndërlidhja”, do të ndjekë procesin e vazhdueshëm të implementimit dhe arritjes së objektivave të këtij dokumenti.

Neni 17
Rishikimi

Dokumenti i politikave spektrale do të rishikohet periodikisht, në varësi të zhvillimeve teknologjike dhe angazhimeve ndërkombëtare.

ANEKSI 1
INFORMACION MBI BREZAT E FREKUENCAVE GSM/UMTS/IMT/LTE, TË DHËNË
NË PËRDORIM, PËRFSHIRË SPEKTRIN E PAALOKUAR

I. Brezi 800 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Teknologjia	Kohëzgjatja e autorizimit
Vodafone Albania sh.a.	801–811	842–852	FDD	4.3.3034
Telekom Albania sh.a.	811–821	852–862	FDD	27.9.2034
-----	791–801	832–842	FDD	Spektër i paalokuar

II. Brezi 900 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Teknologjia	Kohëzgjatja e autorizimit
Vodafone Albania sh.a.	906.6–906.8	951.6–951.8	FDD	1.6.2030
	907.0–914.8	952–959.8		9.6.2031
	880.4–881.00	925.40–926.00		1.6.2030
	881.20–881.60	926.20–926.60		1.7.2030
	881,80	926,80		25.6.2024
	882.0–885.6	927.0–930.6		25.6.2024
Telekom Albania sh.a.	886.0–889.8	931.0–934.8	FDD	25.6.2024
	890.2–898.0	935.2–943.0		19.8.2029
Albtelecom sh.a.	898.4–906.2	943.4–951.2	FDD	1.3.2034

III. Brezi 1800 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Teknologjia	Kohëzgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania sh.a.	1735.8–1735.9	1830.8–1830.9	FDD	25.6.2024
	1736.0–1740.2	1831.0–1835.2		25.6.2024
	1740.6–1763.8	1835.6–1858.8		Për 9 MHz: 9.6.2031 Për 14.4 MHz : 1.4.2030
Telekom Albania	1710.2–1731.0	1805.2–1826.0	FDD	Për 9 MHz:

sh.a				19.8.2029 Për 12 MHz: 1.4.2030
	1731.4–1735.6	1826.4–1830.6		25.6.2024
	1735.7–1735.8	1830.7–1830.8		25.6.2024
Albtelecom sh.a	1764.0–1733.0	1859.0–1868.0	FDD	1.3.2034
	1733.2–1784.8	1868.2–1879.8		1.4.2030

IV. Brezi 2100 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Teknologjia	Kohëzgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania sh.a.	1920–1935	2110–2125	FDD	31.12.2025
	1965–1970	2155–2160		6.11.2029
	1970–1975	2160–2165		1.4.2031
	1900–1905		TDD	31.12.2025
Telekom Albania sh.a.	1935–1950	2125–2140	FDD	30.10.2026
	1975–1980	2165–2170		1.4.2031
	190 –1910		TDD	30.10.2026
Albtelecom sh.a.	1950–1965	2140–2155	FDD	30.11.2027
	1910 – 1915		TDD	

V. Brezi 2600 MHz:

Sipërmarrësi	Brezi i frekuencave, Uplink (MHz)	Brezi i frekuencave, Downlink (MHz)	Teknologjia	Kohëzgjatja e Autorizimit
Vodafone Albania sh.a.	2530–2550	2650–2670	FDD	1.5.2030
	2570–2590		TDD	
Telekom Albania sh.a.	2510–2530	2630–2650	FDD	1.5.2030
Albtelecom sh.a.	2550–2570	2670–2690	FDD	1.5.2031
-----	2500–2510	2620–2630	FDD	Spektër i paalokuar
	2590–2620		TDD	

ANEKSI 2
PËRDORIMI AKTUAL I BREZIT PËR TRANSMETIME AUDIOVIZIVE (PËR PLOTËSIM AMA)

Plani frekuencor numerik për 2 rrjetet kombëtare publike të operatorit publik shqiptar (RTSH)

Rrjetet, Shqipëria	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastrë	Vlorë
RTSH (MUX-1)	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
RTSH (MUX-2)	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Plani frekuencor numerik për 5 rrjetet kombëtare private në brezin UHF

Rrjetet kombëtare private	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastrë	Vlorë
KLAN (MUX-3)	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
DIGITALB (MUX-4)	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
TOP CHANNEL (MUX-5)	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
MEDIA VIZION (MUX-6)	22	36	54	-----	57	46	29	24	21	48	53
ADTN (MUX-7)	51	52	60	-----	39	40	45	47	27	35	51

Kanali frekuencor Ch 37 i është dhënë në përdorim shoqërisë “Era-Digital” sh.p.k., për ofrimin e transmetimeve audiovizive numerike në allotmentin Elbasan.

PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Aktiviteti	Institucionet e ngarkuara	Afati
I	Dividenti Digital 2		
I.1	Konsultimi i parë mbi opsionet teknike të migrimit të frekuencave	MIE, AMA, AKEP	Shtator 2020
I.2	Konsultimi i dytë mbi opsionet teknike të migrimit të frekuencave	MIE, AMA, AKEP	Tetor 2020
I.3	Konsultimi i tretë mbi opsionet teknike dhe dakordësimi për opsionin më të mirë	MIE, AMA, AKEP	Dhjetor 2020
I.4	Hartimi i planit të detajuar të masave	AMA, MIE, AKEP	Dhjetor 2020
I.5	Përgatitja e propozimeve për masat ligjore dhe rregullore për migrimin e frekuencave	MIE, AMA, AKEP	Janar–shkurt 2021
I.6	Konsultim i propozimeve ligjore e rregullore	MIE, AMA, AKEP	Mars–prill 2021

I.7	Miratimi i propozimeve/ndryshimeve të mundshme ligjore për realizimin e lirim të DD2	MIE, AMA	Dhjetor 2021
I.8	Koordinimi ndërkufitar për DD2	AMA, MIE	Qershor–dhjetor 2020
II.	Krijimi i inventarit		
	Miratimi i udhëzimit të ministrit	MIE	Shtator 2020
	Krijimi i një baze të përbashkët të të dhënave për përdorimin aktual të gjithë spektrit	AKEP, AMA	2021 e në vijim
	Krijimi i një sistemi <i>software</i> për administrimin e spektrit /inventarit	AKEP	2021 e në vijim
III	Planifikimi afatgjatë i spektrit		
	Studimi për kërkesën afatgjatë për spektër për shërbime të ndryshme në intervalin 400 MHz – 6GHz;	AKEP, AMA, MIE	2021–2022
	Identifikimi i brezave ku ka nevojë për përmirësim të eficiencës	AKEP, AMA, MIE	2021–2022
	Ndërmarrja e masave rregulluese për rritjen e eficiencës	AKEP, AMA	2023–2025
IV	Rishikimi i PKF		
	Shqyrtimi i akteve finale të WRC-19	MIE	Qershor 2020
	Analiza e ECA 2020	MIE	Tetor 2020
	Përgatitja e ndryshimeve dhe miratimi PKF	MIE, AKEP, AMA, MM, MB, SHISH	Dhjetor 2020
V	Rritja e kapaciteteve teknike		
	Krijimi i një sistemi <i>software</i> bashkëkohor për administrimin e spektrit/inventarit të spektrit	AKEP	2021–2022
	Trajnimi i stafit për planifikimin dhe administrimin e spektrit	MIE, AKEP, AMA	2020 e në vijim
	Rritja e pjesëmarrjes në grupet e studimit të ITU-R për spektrin	MIE, AKEP, AMA	
VI	Sistemi i pagesave për përdorimin e spektrit		
	Kryerja e analizës së skemës aktuale të pagesave për spektrin dhe identifikimi i shërbimeve, brezave ku ka nevojë për rregullim, si shërbimet satelitore, përdorimet për kërkim, testim etj.	MIE, AKEP, AMA	2020–2021
	Përgatitja e propozimeve për ndryshime në kuadrin ligjor/nënligjor përkatës	MIE, AKEP, AMA	2021–2022
VII	Bashkëpunimi ndërkombëtar		
	Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkufitar, për koordinimin dhe harmonizimin e spektrit të frekuencave të brezave të rëndësishëm për shërbimet e lëvizshme, shërbimet fikse dhe audiovizive	MIE, AKEP, AMA	2020 e në vijim
	Rritja e pjesëmarrjes në grupet e studimit të ITU-R për spektrin	MIE, AKEP, AMA	2020 e në vijim
	Pjesëmarrja në konferencën e WRC	MIE, AKEP, AMA	2020 e në vijim
	Pjesëmarrja në takimet e CEPT/ECO	MIE, AKEP, AMA	2020 e në vijim
VIII	Ekonomia e gjelbër		
	Kryerja e studimit për eficiencën e spektrit radio dhe ndikimin në mjedis	MIE, AKEP, AMA	2021–2022